



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 125, datë 31.08.2020**

**PËR**

**MIRATIMIN E AGJENTIT NË SIGURIME, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË  
SHOQËRISË SË SIGURIMIT “ALBSIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbiqëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 194, pika 2, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, Bordi i Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Licencimin e subjektit “G.S.K.” sh.p.k., për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime, në klasat e Jo-Jetës, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit “Albsig” sh.a.
2. Miratimin e z. Edmond Ademaj, për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime, në klasat e Jo-Jetës, në emër dhe për llogari të subjektit “G.S.K” sh.p.k.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ANËTAR**

**Deniz DERALLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Ervin METE**